

KONTRATË SHIT - BLERJE KUOTË

Sot, më datë 22.12.2020 (dymijë e njëzetë), u paraqitën Shitësi dhe Blerësi, të cilët ranë dakord për hartimin e kësaj Kontratë me termat e mëposhtme:

SHITËSI: Shoqëria Tregtare "Albanian General Electricity" Sh.a., subjekt i së drejtës shqiptare, e regjistruar me numër identifikimi Nipt Nr. L41706021V, përfaqësuar nga administratori i saj Z. Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, më 27.03.1990 dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër: 032266246 dhe numër personal J00327070S, ortak dhe zotërues i 50% i kuotave të Kapitalit themeltar me të drejtë vote 50 % në Shoqërinë "AGE Erzen" Sh.p.k.;

BLERËSI: Lavdosh Bala, shtetas shqiptar, i biri i Hakiut dhe i Hysmianit, i datëlindjes 22.09.1954, i lindur në Vlorë, banues në Vlorë në adresën : Rruga "Çamëria", Lagja "10 Korriku", Skelë Vlorë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër: BA5401920 dhe numër personal F409220430.

OBJEKTI: Shitja e kuotave të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., në masën 50% të kapitalit themeltar, nga "Albanian General Electricity" Sh.a., dhe blerja e tyre nga Z. Lavdosh Bala.

PARAKUSHTE:

- "Albanian General Electricity" Sh.a., është ortak i Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me Nr. L51810011P, dhe zotëron në këtë shoqëri një kuotë të saj, e cila përfaqëson 50% të masës së kapitalit të kësaj shoqërie.
- Z. Lavdosh Bala është ortak i Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me Nipt Nr. L51810011P, dhe zotëron në këtë shoqëri një kuotë të saj, e cila përfaqëson 50 % të masës së kapitalit të kësaj shoqërie.
- Z. Lavdosh Bala, ka kërkuar dhe dëshiron të blejë pjesën në masën prej 50% të kapitalit të shoqërisë që Ortaku "Albanian General Electricity" Sh.a., zotëron në Shoqërinë "AGE Erzen" Sh.p.k., dhe "Albanian General Electricity" Sh.a., dëshiron të shesë pjesën prej 50% të kuotës që ajo zotëron në Shoqërinë "AGE Erzen" Sh.p.k.
- Blerësi Z. Lavdosh Bala për të realizuar këtë blerje kuotash është njohur me çdo të dhënë dhe tregues të aktivitetit tregtar të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., të gjendjes ekonomike, financiare dhe juridike të saj, të drejtave dhe detyrimeve civile, administrative dhe tatimore, aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë, dhe deklaron se i pranon dhe nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me to, dhe se nuk do të ngrejë asnjë pretendim ndaj tyre dhe asnjëherë në të ardhmen. Ai deklaron se është në dijeni të plotë të Kontratave që Shoqëria "AGE Erzen" Sh.p.k., ka nënshkruar deri në datën e lidhjes dhe kësaj kontratë si dhe gjithë detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata.



13.910

- Shoqëria "AGE Erzen" Sh.p.k., ndodhet në fazën kur ka marrë Miratimin Përfundimtar për ndërtimin e Hec Hekal dhe është në pritje për të marrë lejen e ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit.
- Me vendimin e datës 22.12.2020 të Ortakëve të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., u vendos blerja e kuotës në masën 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., përkatësisht nga blerësi Z. Lavdosh Bala.

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., në masën prej 50 % të kapitalit themeltar, kuotë e cila zotërohet nga ortaku i shoqërisë "Albanian General Electricity" Sh.a., me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre përkatësisht nga Z. Lavdosh Bala në cilësinë e blerësit në këtë kontratë.

Shitja e kuotës së mësipërme, e cila përben 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., sjell humbjen e së drejtës së pronësisë së ortakut "Albanian General Electricity" Sh.a., në masën prej 50% të kapitalit të shoqërisë, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, dhe blerësi përfiton po në këtë masë.

KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, struktura e kapitalit të Shoqërisë Tregtare "AGE Erzen Sh.p.k", do të jetë si me poshtë:

1. Z. Lavdosh Bala zotëron 1 (një) kuotë, në masën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k.

Transferimi i së drejtës së pronësisë mbi kuotën do të jetë njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe pagesës së çmimit sipas përcaktimeve të Nenit 2 të kësaj kontrate.

NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE PAGESA

Çmimi i këtij transaksioni shit – blerja kuotë të Shoqërisë "AGE Erzen" Sh.p.k., do të jetë shuma prej 100.000 (njëqind mijë) lek, për tu paguar Shoqërisë "Albanian General Electricity" Sh.a., nga blerësi Z. Lavdosh Bala.

Blerësi deklaron se e gjithë vlera e kësaj kontrate do të paguhet në numrin e llogarisë 21035335301 që shoqëria Albanian General Electricity Sh.a ka pranë Intesa SanPaolo Bank Albania. Shuma prej 100.000 (njëqind mijë) lek do të paguhet brenda 10 ditëve nga firmosja e kontratës.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET MBI KUOTAT

Blerësi është i ndërgjegjshëm për të drejtat dhe detyrimet që ka kuota që ai do të bëhet titullar i saj. Ai pranon dhe deklaron që ka bërë due diligence ligjore dhe financiare dhe pranon fitimin e pronësisë me të drejtat dhe detyrimet që ka kuota.



13.9.13

NENI 4
DISPOZITA TË FUNDIT

Ligji i zbatueshëm është shqiptar. Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe, me 3 (tre) flete secila (nga 1-3), nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

PALËT

SHITËSI:

"Albanian General Electricity" Sh.a
Perfaqësuar nga Administratori
Z. Besar Hapashitica



BLERËSI:

Z.Lavdosh Bala

LAVDOSH BALA
13 #9